



Datë: 23.04.2026

A.nr.81/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.80/2026, të datës 26.01.2026 dhe ankesës me numër A.nr.81/2026, të datës 26.01.2026, të parashtruar nga ankuesi R.A, të bashkuara sipas Vendimit VK./2026, të datës 13.02.2026, të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datë 23.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.81/2026, e datës 28.01.2026, e parashtruar nga ankuesi R.A.

II. Shfuqizohen Vendimi me numër Reference: DS-026/2026, i datës 19.01.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Vendimi GJ.Th.nr.01/2026, i datës 16.01.2026, i Udhëheqësit të Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 14.01.2026, *ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.*

III. Obligohet Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë ri vlerësimin e ankuesit lidhur me përvojën provues, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim lidhur për veprimet e ndërmarra në kuptim të zbatimit të këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Ankuesi R.A (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesi), më datë 22.01.2026, përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 26.01.2026 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.80/2026, kundër Vendimit me numër Reference: DS-026/2026, të datës 19.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, ndërsa, më datë 20.01.2026 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 26.01.2026 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.81/2026, kundër formularit të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 14.01.2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.01.2026 dhe 03.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më datë 30.01.2026 dhe 04.02.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorie administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 400/2026 të datës 26.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Akt Emërimit të datës 19.12.2025; Referencën për ankuesin e datës 20.01.2026 nga Gjyqtarja Florije Qerimi; Referencën për ankuesin nga Sekretarja Juridike Vahide Dërmaku; Referencën për ankuesin nga Gjyqtarja Mirvete Alidema; Listën e lëndëve të përfunduara nga ankuesi 01.09.2025-15.01.2026; Vendimin A.nr.1837/2025 të KPMSHCK-së; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 14.01.2026; Emailin e datës 14.01.2026 nga M.H për ankuesin; Vendimin me numër Reference: DS-026/2026, i datës 19.01.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit; Zarin e datës 22.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 30.01.2026; Vendimin GJ.Th.nr.01/2026, të datës 16.01.2026, të Udhëheqësit të Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjiçan; Shënim Zyrtar ASHC.nr.15/2025 i datës 18.09.2025; Shënim Zyrtar ASHC.nr.14/2025 i datës 15.09.2025; Shënim Zyrtar ASHC.Nr.13/2025 i datës 12.09.2025; Shënim Zyrtar ASHC.nr.12/2025 i datës 04.09.2025; Vërejtje me shkrim ASHC.nr.16/2025 datës 06.10.2025; Emailin e datës 15.12.2025 nga K.H për V.Sh; Akt Emetimit të datës 18.07.2025; Ankesën me numër protokolli 402/2026 të datës 26.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 20.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 04.02.2026; Raportin e vijueshmërisë në punë për ankuesin datës 01.09.2025 deri 31.12.2025; Vendimin VK./2026 të datës 13.02.2026, të Kryesuesit të KPMSHCK-së, për bashkimin e ankesave.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, **është e bazuar, sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër Referencë: DS-484/2025, të datës 18.07.2025, ka themeluar marrëdhënies punës në pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Gjilan, me periudhë provuese gjashtë (6) muaj duke filluar nga data 18.07.2025 deri 17.01.2026.
- Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, më datë 14.01.2026, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin duke e vlerësuar me notën e përgjithshëm 1.2.
- Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë, më datë 16.01.2026, ka nxjerr Vendim GJ.Th.nr.01/2026, me të cilin nuk ka konfirmuar marrëdhënien e punës së ankuesit, me arsyetimin se prej themelimit të marrëdhënies së punës ka pasur probleme të theksuara dhe të vazhdueshme në raport me respektimin e orarit të punës, vendit dhe detyrave të punës.
- Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, bazuar në vendimin e datës 16.01.2026 të Udhëheqësit të Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan, më datë 19.01.2026, ka nxjerrë Vendimin Referencë: DS-026/2026, me të cilin ankuesit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës si rezultat i mos konfirmimit të periudhës provuese.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër Reference: DS-026/2026, të datës 19.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 14.01.2026, me pretendimet së vendimi i kundërshtuar me ankesë dhe vetë vlerësimi janë të papranueshëm sepse nuk ka asnjë bazë ligjore për mos konfirmim të periudhës provuese sepse përveç tjerat vlerësimin e ka bërë pikërisht një person që edhe vetë është në periudhë provuese dhe nuk ka kredibilitet të më vlerësoj nga data 21.07.2025 deri shtator të këtij viti sepse nuk ka qenë mbikëqyrës i drejtpërdrejtë. Kam kryer të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që kam pasur si dhe kam kryer edhe punë të tjera ku kohë pas kohë kam përkthyer kur përkthyesit kanë qenë në pushime meqë e njeh gjuhën serbe. Nëse gjyqtarja që kam punuar me të ka qenë e pakënaqur me punën time ka mundur të kishte kërkuar ndërrimin tim me një zyrtar tjetër, pasi që kjo është edhe praktikë. Se në arsyetim të vendimit përmendet se kam pasur gjuhë të papranueshme, sjellje arrogante gjatë kësaj kohe dhe nuk kam respektuar orarin e punës dhe gjithashtu ka pasur shënim zyrtar dhe ankesë verbale dhe për të gjitha këto unë nuk kam qenë i informuar pasi që kjo ka qenë obligim ligjor. Kërkon që të anulohen aktet e kundërshtuara dhe të obligohet institucioni për rikthimin tim në vendin e punës me të gjitha të drejtat.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me të cilin përcaktohet se: 1. *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara*

shprehimisht në ligj., dhe si rrjedhojë, Kolegji fillimisht konstaton së KMPShCK-ja ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi ka legjitimitetin e palës në procedurë dhe së ankesa konsiderohet e parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 127, paragrafi 1 të LPPA-së.

Përkitazi më statusin ligjor të të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, kështu që, nisur nga ky përcaktim ligjor të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion i sistemit të drejtësisë ka rregulluar me akt të veçantë në ligjor procedurën e pranimit dhe vlerësimit të rezultateve në punë përfshirë edhe vlerësimin gjatë periudhës provuese gjegjësisht me Rregulloren Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Emërimit, dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor dhe Rregulloren Nr. 10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në punës për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Ndërsa, në kuptim të bazueshemërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referua Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Emërimit, dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me theks të veçantë:

Nenit 29 Puna provuese 1. *Nëpunësi, pas emërimit në administratën e sistemit gjyqësor para fillimit të punës, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjat gjashtë (6) muaj. 2. Puna provuese është përgatitja teorike dhe praktike e nëpunësit për kryerjen me sukses detyrave të pozitës ku është emëruar/ka filluar punën. të 3. Puna provuese pezullohet për kohëzgjatjen aktuale të pushimit të lehonisë, pushimit të atësisë, pushimit prindëror, pushimit mjekësor, shërbimit ushtarak, fushatës zgjedhore dhe/apo rrethanave të tjera të veçanta. Pas përfundimit të shkaktit të pezullimit, periudha e provës zgjatet për kohën sa është bërë pezullimi. 4. Nëpunësi pas emërimit në administratën e sistemit gjyqësor, gjatë periudhës provuese nuk ka të drejtë që të merr pjesë në komisionet përzgjedhëse, komisionet disiplinore, komisionet e ankesave apo që të caktohet si zëvendësues në ndonjë pozitë tjetër.*

-Nenit 30 Vlerësimi gjatë periudhës provuese 1. *NjMBNj, tridhjetë (30) ditë para përfundimit të periudhës provuese, kërkon me shkrim mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i të punësuarit, që të bëjë vlerësimin e punës provuese. nga 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takim me të punësuarin, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të punës provuese dhe bashkë me të trajton performancën e tij. 3. Njoftimi për takimin lidhur me vlerësimin e punës provuese i dërgohet të punësuarit së paku tre (3) ditë para datës së takimit. 4. Mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të punësuarit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos: 4.1. konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit; 4.2. zgjatjen e periudhës provuese një herë të vetme, deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit; 4.3. moskonfirmimin e marrëdhënies së punës në administratën e sistemit gjyqësor të nëpunësit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës. 5. Vendimin e arsyetuar për konfirmimin ose mos konfirmimin e punës së nëpunësit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e dërgon tek NjMBNj së paku dhjetë (10) ditë para përfundimit të punës së tij provuese. 6. Në rast të mos*

konfirmimit të marrëdhënies së punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, merret vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, ka analizuar aktet e kontestuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, dhe si rrjedhojë ka gjetur se ankuesi është vlerësuar në pesë objektiva si: 1.Mbështetja profesionale për gjykatën; me notë të vlerësimit 1; 2.Përgatit Lëndë/Siguri pjekuri të shërbimeve të sekretarisë administrative; më notë të vlerësimit 2; 3.Siguron/pjekuri të shërbimeve të sekretarie administrative, më notë të vlerësimit 1; 4.Respekton kodin e mirësjelljes dhe për punën e vetë, më notë të vlerësimit 1 dhe 5. Për punën e vet, më notë të vlerësimit 1, kurse pjesa e aftësive dhe sjelljes profesionale është vlerësuar “ e pa pranueshme” dhe “ ka nevojë për përmirësim”, ashtu që, nota e përgjithshme del të jetë 1.2, apo “ e pa pranueshme”, vlerësim ky që bazohej në shënime zyrtare, Vërejtje më shkrim dhe ankesën e datës 23.12.2025.

Rrjedhimisht, në shkresat e lëndës ekzistojnë shkresa materiale që kanë evidentuar mos respektimin e orarit të punë nga ankuesi si dhe mos përmbushje të detyrave të punës, si: Shënimi zyrtar ASHC.nr.12/2025, i datës 04.09.2025, i u.d Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjilan, më të cilin është konfirmuar së ankuesi i caktuar që të punoj në zyrën e gjyqtares Kaltrina Haliti, ka disa herë që vonohet në punë, del para orës 12 në pauzë, vonohet nga kthimi në pauzë dhe së për këto veprime është njoftuar ankuesi dhe është kërkuar që të respektohet orari i punës si obligim që rrjedhë nga kontrata; Shënimi zyrtar ASHC.nr.13/2025, i datës 12.09.2025, i Udhëheqësit të Zyrës për Mbështetje Juridike, më të cilin ky i fundit ka potencuar së gjyqtarja Kaltrina Haliti ka paraqitur shqetësimet e saj sa i për ketë ankuesit, më arsyetimin së i njëjti nuk respekton orarin dhe vendin e punës dhe së nuk është funksional sa i për ketë detyrave të punës; Shënimi zyrtar ASHC.nr.14/2025, i datës 15.09.2025, i ud Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjilan, më të cilin është konfirmuara së ankuesi është vonuar në punë më arsyetimin se ka qenë i sëmur duke mos lajmëruar eprorin e tij e as administratorin e gjykatës; Shënimi zyrtar ASHC.nr.15/2025, i datës 12.09.2025, i Udhëheqësit të Zyrës për Mbështetje Juridike, më të cilin është evidentuar se”.. zyrtarin e kam takuar në zyrën time së bashku më kryetarin dhe e kemi njoftuar për këto ankesa të gjyqtaresh dhe te ud. Administratorit sa i për ketë mos respektimit të orarit te punës dhe kryerjes së punëve në zyrën e gjyqtares në fjalë. .. I njëjti sa i parkete mos respektimit te orarit dhe vendit të punës, fillimisht ka mohuar e më pas ka arsyetuar duke thënë se i duhet me dal me herët për shkak se ne dalje të gjykatës gjate procesit të nënshkrimit bohet tollovi dhe duhet te pres mu nënshkru, kjo në përfundim të orarit, kurse ne fillim dhe gjate pauzës është arsyetuar së të gjithë po vonohen, kurse sa i për ketë ankesës për angazhim në zyrë është arsyetuar se po mundohet edhe nuk e ka “Nder mend me lanë shpirtin në punë”... në konsultim më kryetarin dhe ud. Administratorin kemi vendosur që mos te i shqiptojmë vërejtje, pasi që kemi biseduar ne mënyrë shumë korrekte dhe ndoshta do te reflektoj ne te ardhmen”; Vërejtja më shkrim ASHC. Nr.16/2025, e datës 06.10.2025, e shqiptuar ndaj ankuesit nga Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike, për shkak të shkeljes deltinore “mungesës në punë dhe mos njoftim i personit përgjegjës “ si dhe Emaili i datës 15.12.2025, i gjyqtares K. Halili drejtuar zyrtarit V.S, me të cilin kjo e fundit kishte sqaruar se: Siç e dini në zyrën time është angazhuar zyrtari i ri ligjor R.A, i cili punën në zyrë e ka filluar diku në muajin gusht të këtij viti, me këtë email parashtroj ankesë-kërkesën time zyrtare lidhur me sjelljen dhe moskryerjen e detyrave të punës nga zyrtari i lartcekur. Gjatë kësaj periudhe kohore kam vrojtuar në mënyrë të përsëritur shkelje të detyrave të punës dhe kohë pas kohë mospërfillje e përgjegjësi dhe

mungesë serioziteti gjate ushtrimit të funksionit zyrtar dhe pas kaq muajve vazhdim i detyrave në mënyrë sipërfaqësore. .. I njëjti ka sjellje të pa pranueshëm-gjuhë jo të pranueshme më përgjigje arrogante posaçërisht kur i tërhiqet vërejtja nga ana ime, ... dhe se kjo sjellje është përsëritur disa herë nga ana e tij...”

Rrjedhimisht, në vlerësimin e kolegjit është fakt i pakontestueshëm se ankuesi ka qenë i caktuar në Zyrën e Gjyqtarës. K. Halili, i njëjti për punën e tij përgjigjet dhe raporton tek Udhëheqësi i Zyrës Juridike dhe gjyqtari i caktuar dhe së ka shënime zyrtare nga tri organe (administratori, udhëheqësi dhe gjyqtarja) që evidentojnë pakënaqësi dhe vërejtje në raport me ankuesit përkitazi me mos respektim të orarit të punës dhe mos përmbushje të detyrave të punës, mirëpo, nga analizimi i provave materiale të çështjes nuk ka dëshmi që vërteton faktin se ankuesi ishte njoftuar me këto shënime zyrtare, si një nga pretendimet ankimore dhe së masa disiplinore “ Vërejtje me shkrim” e datës 06.10.2025, ishte anuluar nga Këshilli me Vendimin A.nr.1837/2025 të datës 03.12.2025, andaj dhe si e tillë kjo masë nuk ka mundur të merret si referencë me rastin e vlerësimit të ankuesit të datës 14.01.2026.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe raportin e vijueshmërisë në punë për periudhën 01.09.2025 deri 31.12.2025, nga dhe ka vërtetuar së ky raport përmban regjistrime vetëm për hyrje dhe dalje në punë për ankuesin, gjegjësisht referuar këtij raport Kolegji ka gjetur së ankuesi për datën 02.10.2025 ka bërë evidentim për hyrje në punë në ora 11:21 ndërsa, dalja nga punë është regjistruar në ora 16:01, dhe së më datë 03.10.2025 ankuesi fare nuk ka bërë regjistrim, ndërsa lidhur me ditë tjera në punë ka regjistrim të rregullt të vijueshmërisë në punë.

Po ashtu, sipas provave të dërguara nga vet ankuesi rezulton se gjyqtarja Floreine Qerimi sipas referencës së datës 20.01.2026 për ankuesin ka deklaruar se nga data 05.01.2026 deri më datë 09.01.2026 ka qenë i angazhuar në zyrën e saj për shkak së zyrtari ligjor i caktuar në zyrën e saj ka qenë në pushim dhe gjatë kësaj kohë ka treguar përkushtim, korrektësi dhe angazhim profesional, gjyqtarja Mirvete Alidema në referencën për ankuesi deklaroi se edhe përkundër që i njëjti është i angazhuar në një zyre tjetër, në kohën kur zyrtarja e saj është në pushim i njëjti gjithmonë ka ofruar asistencë kur ka pasur vështirësi të punëve administrative dhe ka pasur përkushtim të lartë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi dhe është korrekt duke jep maksimumin.

Andaj, mbi bazën e konstatimeve si më sipër dhe rrethanave si më lartë, Kolegji nuk ka mundur të vendosë meritorisht lidhur me këtë çështje juridik -administrative, kështu që, më qëllim të ligjshmërisë, Kolegji vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të shfuqizoj aktet e kontestuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim të Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike, më detyrimin që ky i fundit në ri procedurë, vlerësimin e periudhës provuese të ankuesit ta mbështes dhe ta argumentoj me provave materiale bindëse, të merr parasysh vlerësimin e zyrtarit që ka ushtruar pozitën e mbikëqyrësit të ankuesit për periudhën 21.07.2025 deri shtator 2025, dhe të argumentoj me prova materiale faktet lidhur më vërejtjet dhe pakënaqësitë që i janë dhënë ankuesit gjatë periudhës provuese.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.81 /2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit R.A;
- SKGJK: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së